



BULETIN



PËRGJEGJSHMËRIA E DEPUTETËVE DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin informativ / Nr.33

TETOR 2006

Projekt i QSP-së për Monitorimin e Veprimtarisë së Parlamentit me Mbështetjen e Fondacionit "Shoqëria e Hapur" SOROS

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE 25 shtator - 16 tetor 2006

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

1. Gjatë periudhës 25 shtator – 16 tetor 2006 Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar. Në 6 mbledhje janë zhvilluar gjithsej 224 minuta punë efektive në komision ose mesatarisht 37 minuta për mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme, të propozuar nga Këshilli i Ministrave, në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse. Më datë 2 tetor Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë zh-

(Vijon në faqen 2)

PROJEKTLIGJE NË PROCES Projektligji "Për Organizimin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"

RELACION

Projektligji synon rritjen e mëtejshme të garancive për një gjyqësor të pavarur, përmirësimin e imazhit dhe forcimin e autoritetit të tij në sytë e qytetarëve, në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe kundër shkeljeve të tjera ligjore, nëpërmjet:

1. Një riorganizimi gjyqësor efektiv, në përputhje me kushtet e vendit dhe nevojat e zhvillimit;
2. Përmirësimin të kriterëve dhe normave, që rregullojnë kamerën e gjyqtarëve, duke u dhënë përparësi integritetit dhe profesionalizmit të tyre.
3. Përcaktimit të kriterëve përzgjedhëse për kryetarët e gjykatave të shkallës së parë e të apelit, si dhe të detyrave të tyre, për të garantuar funksionimin, normal dhe efektiv, të gjykatave.

(Vijon në faqen 6)

Në këtë numër do të lexoni:

1. Nga Monitorimi i Veprimtarisë së Komisioneve Parlamentare për periudhën 25 shtator - 16 tetor 2006

faqe 1-3

2. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave për muajin tetor 2006

faqe 4-5

**3. Projektligje në proces
Projektligji "Për Organizimin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"**

faqe 6-12

**4. Projektligje të miratuara
në Kuvend shtator 2006.**

faqe 13

**5. Projektligje të depozituara
në Kuvend shtator-tetor 2006.**

faqe 13

6. Kalendarit 3 javor i Kuvendit të Shqipërisë

16 tetor - 6 nëntor 2006

faqe 1, 14-15

KALENDAR I

**3 Javor (16 tetor - 6 nëntor 2006) i Punimeve të Kuvendit
Sesioni i III-të Legjislatura e XVII-të**

E Hënë, datë 16.10.2006, ora 17.00

- Seancë Plenare

1. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60').
2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare, datë 9.10.2006.
3. Miratimi i Kalendarit 3 javor të punimeve të Kuvendit.
4. Interpelancë me Ministrin e Brendshëm, kërkuar nga deputetët Taulant Balla dhe Rrapush Tola.
5. Interpelancë me Ministrin e Brendshëm, kërkuar nga deputetët Petro Koçi, Piro Lutaj dhe Stefan Çipa.

(Vijon në faqen 14)

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

25 shtator- 16 tetor 2006

(Vijon nga faqja 1)

villuan një mbledhje të përbashkët, nën drejtimin e Kryetares së Kuvendit, Jozefina Topalli, me praninë e përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile. Në këtë mbledhje u prezantua dhe u shqyrtua në parim projektligji: "Për disa masa kundër dhunës në familje" i propozuar nga 20.000 zgjedhës. Ky projektligj vjen si një nismë e shoqërisë civile të përfaqësuar nga një aleancë e përbërë nga Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve, Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, Aleanca Gjinore për Zhvillim, Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin, Refleksione dhe Strehëza për Gratë e Dhunëara, Shoqata në Dobi të Gruas Shqiptare, Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Klinika Ligjore për të miturit dhe Qendra Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Projektligji u prezantua në emër të gjithë inisiatorëve të përmendur më sipër ana e tij, nga drejtuesi i ZMQ-së, Kreshnik Spahiu. Pas paraqitjes së projektligjit dhe argumenteve të sjella nga z. Spahiu, si dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile si dhe deputetëve të dy komisioneve, në përfundim të mbledhjes deputetët e miratuan projektligjin unanimisht në parim.

3. Edhe gjatë kësaj periudhe është konstatuar se vetëm një pjesë e deputetëve marrin pjesë në diskutime dhe debate. Gjatë zhvillimit të mbledhjeve, vetëm një pakicë e deputetëve shfaqin interes për projektligjet që diskutohen. Jo rallë vërehet që disa deputetë lexojnë shtypin e ditës, disa të tjerë tjerë flasin në celular. Bazuar në pjesëmarrjen e tyre, pjesa më e madhe e deputetëve nuk ka rezultuar të jenë informuar paraprakisht për projektligjet që shqyrtohen në komision. Në 6 mbledhje të realizuara numërohen rreth 14 diskutime nga deputetët dhe shumica e tyre janë bërë në mbledhjen e datës 2 tetor (të përmendur më lart). Gjithashtu janë propozuar 2 amendamente.

4. Në 6 mbledhjet e zhvilluar gjatë kësaj periudhe janë konstatuar mungesa të shumta të deputetëve. Gjatë zhvillimit të mbledhjeve numri i deputetëve të pranishëm në mbledhje nuk është i njëjtë me fillimin e mbledhjes, por në ndonjë rast janë më pak se sa kërkohet për kuorumin për votim. Gjithashtu deputetët vazhdojnë të vijnë me vonesë në mbledhje dhe si rrjedhojë edhe mbledhjet fillojnë me vonesë. Ka patur edhe raste kur deputetët vetëm sa kanë firmosur prezencën dhe janë larguar përsëri ndërkohë që mbledheja ka vazhduar normalisht. Gjatë monitorimit është konstatuar që numri i deputetëve që mungojnë është më i madh se ai i paqyruar në p.ç.v. Në mbledhjen e datës 9.10.2006 sipas p.ç.v mungojnë 2 deputetë por në fakt nga monitorimi rezulton se munojnë 5 deputetë. Po kështu ka ndodhur edhe në mbledhjet e tjera.

5. Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore si dhe nuk janë zhvilluar veprimtari të tjera kontrolluese. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim ose ndonjë raport kontrolli.

6. Mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media.

Disa vlerësime: Siç rezultojnë nga monitorimi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka një pjesëmarrje të rregullt të deputetëve në mbledhjet e komisionit. Deputetët vijnë me vonesë dhe largohen përpara mbylljes së mbledhjes. Gjithashtu, nga verifikimi i procesverbalit dhe informacionit të marrë gjatë monitorimit rezulton se numri i deputetëve që mungojnë është më i madh se ai i paqyruar në p.ç.v. Nuk rezulton një pjesëmarrje aktive e deputetëve në çështjet që diskutohen në komision. Përveç datës 2 tetor 2006 në mbledhjet e tij komisioni ka si burim informacioni vetëm relacionin e projektligjit dhe ekspertët e qeverisë. Mbështetja e Komisionit, gjatë shqyrtimit të çështjeve, vetëm në burimin e informacionit të qeverisë pengon komisionin për të bërë një vlerësim me të gjerë të çështjeve nga shumë këndvështrime dhe duke konsultuar burime të ndryshme.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

1. Gjatë periudhës 25 shtator – 16 tetor 2006 Komisioni i Ekonomisë dhe Financave ka zhvilluar gjithsej 6 mbledhje. Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar, por në dy raste nuk është respektuar data e parashikur në kalendar. Mbledhja e parashikuar më datë 28 shtator është zhvilluar më datë 27. Ndërsa mbledhja e parashikuar më datë 4 tetor është zhvilluar më datë 5. Gjithashtu në kalendar ishin parashikuar 7 mbledhje dhe në fakt janë zhvilluar 6. Mbledhja e datës 9 tetor me rend dite projektligjin "Për Bankën në Republikën e Shqipërisë" nuk është zhvilluar duke kaluar për në kalendarin tjetër. Kohëzgjatja e mbledhjeve varion nga 5 deri në 75 minuta. Gjatë 8 mbledhjeve janë zhvilluar gjithsej 190 minuta punë efektive në komision ose mesatarisht 38 minuta për mbledhje.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qeverisë në mbledhjet e projektligjeve përkatëse. Nuk është shfrytëzuar ndonjë ekspertizë ose burim tjetër, gjatë mbledhjes. Jo të gjithë deputetët kanë marrë pjesë aktive në diskutimet që zhvillohen në mbledhje. Vazhdojnë të jenë më aktivë të njëjtët deputetë që kanë qenë edhe gjatë muajit shtator. Në 6 mbledhje të realizuara numërohen rreth 12 diskutime nga deputetët. Gjithashtu janë propozuar 4 amendamente në 6 projektligje në ndryshme të shqyrtuar në komision. Edhe gjatë kësaj periudhe rezulton se vetëm një pjesë e vogël e deputetëve janë të informuar paraprakisht për projektligjet e shqyrtuar në komision.

3. Përsa i përket pjesëmarrjes së deputetëve në mbledhje gjatë kësaj periudhe është konstatuar se në disa raste mbledhja ka filluar pa u plotësuar kuorumi, ndërkohë që deputetët e tjerë kanë ardhur 20-30 minuta me vonesë. Ka ndodhur gjithashtu që para votimit deputetët e opozitës të largohen dhe votimi është bërë pa kuorumin

(vijon në faqen 3)

NGA MONITORIMI I VEPRIMTARISË SË KOMISIONEVE PARLAMENTARE

25 shtator- 16 tetor 2006

(Vijon nga faqja 2)

e e nevojshëm. Edhe në këto mbledhje mungesat variojnë nga 4 deri në 7, mesatarisht mungojnë 5 deputetë për mbledhje. Përsëri janë konstatuar vonesa të shumta të deputetëve të cilat në disa raste kanë bërë që mbledhja të fillojë me vonesë.

4. Gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore si dhe nuk janë zhvilluar veprimtari të tjera kontrolluese. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim ose ndonjë raport kontrolli.

5. Në dy raste mbledhjet nuk janë zhvilluar sipas orarit të parashikuar në kalendar, por në një orar tjetër para fillimit të seancave plenare. Në këto raste sipas sekretares së komisionit nuk lejohen vizitorët. Në rastet e tjera mbledhjet kanë qenë të hapura. Të pranishëm kanë qenë edhe media.

Disa vlerësime: Gjatë monitorimit janë konstatuar 2 raste (në datat 27 shtator dhe 2 tetor) kur komisioni nuk i ka zhvilluar mbledhjet në kohën e parashikuar në kalendar, por ato janë zhvilluar në një kohë tjetër pak para fillimit të seancave plenare. Sipas p.ç.v të këtyre mbledhjeve rezultoi se ora e zhvillimit të mbledhjeve është e ndryshme nga koha kur janë zhvilluar mbledhjet. Kjo ndodh kryesisht për shkak të mosplotësimit të kuorumit të nevojshëm për votim.

Një problem tjetër i konstatuar gjatë monitorimit ishte largimi i deputetëve nga mbledhja para përfundimit të saj. Nuk rezultoi një pjesëmarrje aktive e deputetëve në çështjet që diskutohen në komision. Siç u përmend dhe më sipër, edhe në këtë Komision konstatohet mbështetja vetëm në burimin e informacionit të qeverisë. Ky fakt pengon komisionin për të bërë një vlerësim me të gjerë të çështjeve nga shumë këndvështrime dhe duke konsultuar burime të ndryshme.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

1. Gjatë periudhës 25 shtator – 16 tetor 2006 Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar gjithsej 3 mbledhje. 2 mbledhje kanë qenë të parashikuara në kalendar, ndërsa mbledhja e datës 12.10.06 nuk ishte e parashikuar në kalendar. Përsëri ndodh që mbledhjet nuk janë të parashikuara më datë dhe orë të caktuar. Më datë 10 tetor kohëzgjatja e mbledhjes ka qenë 1 orë e 50 minuta ndërsa në dy mbledhjet e tjera nga 20 minuta gjithsej 150 minuta punë efektive në komision.

2. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve të ndryshme në mbledhje të komisionit kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues të qeverisë në mbrojtje të projektligjeve përkatëse. Nuk është shfrytëzuar ndonjë ekspertizë apo burim tjetër, gjatë mbledhjes. Gjatë monitorimit është konstatuar se vetëm një pjesë e deputetëve marrin pjesë në diskutime dhe debate. Në 3 mbledhje të realizuara numërohen rreth 8 diskutime nga deputetët. Gjithashtu janë propozuar 3 amendamente gjatë shqyrtimit të projektligjit "Për Artin Skenik". Dy amendamente kanë

qenë të karakterit teknik dhe 1 kishte të bënte me përmbytjen e projektligjit.

3. Në 3 mbledhje të zhvilluara janë konstatuar mungesa të deputetëve në mbledhje. Në mbledhjen e datës 12 tetor opozita nuk morri pjesë dhe si rrjedhojë mungonin 7 deputetë. Sipas informacionit të marrë kjo mbledhje është thirrur nga nënkryetari i komisionit dhe ka patur si objekt zgjedhjen e kandidaturës për Kryetarin e Këshillit Drejtues të RTSH-së. Në këtë mbledhje është zëvendësuar deputeti Spartak Ngjela me deputetin Astrit Patozi.

4. Edhe gjatë kësaj periudhe nuk është zhvilluar asnjë seancë dëgjimore si dhe nuk janë zhvilluar veprimtari të tjera kontrolluese. Nuk është bërë asnjë studim, vlerësim apo ndonjë raport kontrolli.

Disa vlerësime: Mbledhjet kanë qenë të parashikuara në kalendar por jo në datë dhe orë të caktuara. Mbledhja e datës 12 tetor nuk ka qenë e parashikuar në kalendar. Ky fakt krijon vështirësi për ndjekjen e tyre, por edhe për të interesuarit (media, grupe interesi, vizitorë etj). Edhe në këtë Komision konstatohet mbështetja vetëm në burimin e informacionit të qeverisë. Ky fakt pengon komisionin për të bërë një vlerësim me të gjerë të çështjeve nga shumë këndvështrime dhe duke konsultuar burime të ndryshme.

Disa vlerësime të përgjithshme: Në përgjithësi edhe gjatë kësaj periudhe janë konstatuar të njëjtat probleme si dhe gjatë punimeve të kalendarit të parë të punimeve të këtij sesioni. Krahasuar me kalendarin e parë është konstatuar se janë zhvilluar më pak mbledhje dhe si rrjedhojë është bërë më pak punë nga komisionet.

Gjatë kalendarit të dytë janë konstatuar përsëri mungesa të shumta të deputetëve në mbledhje si dhe raste kur deputetët që mungojnë nuk pasqyrohen në p.ç.v. e mbledhjeve të komisioneve. Në disa raste është zhvilluar votim pa qenë i plotësuar kuorumi i nevojshëm.

Gjatë kësaj periudhe janë konstatuar edhe raste kur mbledhja nuk zhvillohet për shkak të mosplotësimit të kuorumit dhe për këtë arsye ajo shtyhet për t'u zhvilluar para fillimit të seancës plenare, por në fakt në p.ç.v. rezultoi se ajo është zhvilluar normalisht, ashtu siç ishte parashikuar në kalendar.

Edhe gjatë kësaj periudhe me përjashtim të një rasti (mbledhja e përbashkët e datës 2 tetor Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë) konstatohet mbështetja vetëm në burimin e informacionit të qeverisë. Ky fakt pengon komisionin për të bërë një vlerësim më të gjerë dhe më të thelluar të çështjeve objekt diskutimi.

*Klesta Hysi
Lindita Troka
Florjan Kalaja*

NGA MBLEDHJET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MUAJIN TETOR 2006

I. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

datë 04.10.2006

VENDIME të Këshillit të Ministrave data 04.10.2006

1. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së garancisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRO), që lidhet me marrëveshjen e kredisë, ndërmjet korporatës elektroenergjitike shqiptare dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), në kuadër të programit të komunitetit të energjisë së Europës juglindore.

2. Autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës të lidhë marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe "CRANS MONTANA FORUM"

3. Miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovenisë, për Transportin ndërkombëtar rrugor të Udhëtarëve dhe mallrave.

4. Miratimin, në parim, të kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin "Cilësi dhe barazi në Arsim".

5. Kodin postar në Republikën e Shqipërisë.

6. Një ndryshim në vendimin nr. 551, datë 2.8.2006, të Këshillit të Ministrave të, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve buxhetorë, për vitin 2006, në Ministrinë dhe institucionet qendrore", të ndryshuar.

7. Disa ndryshime në vendimin nr. 289, datë 17.5.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)".

8. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtëshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i rrugës Berat – Ballaban, prishur si pasojë e shkarjeve në fshatin Rehovë.

9. Lejimin e Ministrisë së Shëndetit të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" në qendrën Spitalore Universitare "IBNI SINA HASTANESI SIHHIYE", Ankara, Turqi, për kryerjen e transplatimit të veshkës për 13 shtetas.

10. Një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Akademinë e Shkencave.

11. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, në bashkinë Peshkopi, të qarkut të Dibrës.

12. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, në Komunën Dropulli i Poshtëm, të qarkut të Gjirokastrës.

13. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, në bashkinë Fushë – Krujë, të qarkut të Durrsit.

14. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, në komunën Horë – Vranisht, të qarkut të Vlorës.

II. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

datë 11.10.2006

VENDIME të Këshillit të Ministrave

datë 11.10.2006

1. Dhënien në përdorim, pa kundërshtim, të disa mjediseve shoqatës së invalidëve të punës.

2. Miratimin, në parim, të marrëveshjes së huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim, për pjesëmarrjen në financimin e projektit të ndërtimit të portit të peshkimit Durrës, Shqipëri.

3. Disa shtesa në vendimin nr.167, datë 29.3.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

4. Miratimin e ndryshimeve në marrëveshjen e kredisë së zhvillimit, IDA 3522-ALB, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e shërbimeve bujqësore.

5. Miratimin e stemës së Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.

6. Krijimin e institucionit shtëpia e pushimit e Ministrisë së Brendshme (SHPMB), Durrës.

7. Shfuqizimin e vendimit nr.73, datë 4.2.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të Bashkisë Delvinë të pronës nr.638, "Ish – Brigadë Këmbësorie", në Rusan, Delvinë, e cila është në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr..515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtëshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes".

8. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për ministrinë e Punëve Publike, transportit dhe Telekomunikacionit, për ALUIZNI-n për realizimin e fotografimit ajror, dixhital.

9. Dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë Universitare, jopublike "Universiteti Polis".

10. Disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 407, datë 21.06.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nënpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës".

11. Lejimin e kalimit tranzit të disa trupave ushtarake turke, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë nga dhe për në Republikën e Malit të Zi e Kosovë.

12. Lejimin e Drejtorisë së Shërbimeve qeveritare të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", për rikonstrukcionin e tarracës së pallatit të Brigadave.

III. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

datë 18.10.2006

VENDIME të Këshillit të Ministrave

datë 18.10.2006

1. Për miratimin e protokollit të bisedimeve, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar e teknik, për vitin 2006.

(vijon në faqen 5)

NGA MBLEDHJET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MUAJIN TETOR 2006

(Vijon nga faqja 4)

2. Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për bashkëpunim në fushën e energjisë.
3. Për miratimin e protokollit të bisedimeve, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 2004.
4. Disa ndryshime në vendimin nr.551, datë 2.8.2006, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve buxhetorë për vitin 2006, në Ministrinë dhe institucionet qendrore", të ndryshuar.
5. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për rehabilitimin e sistemit kullues në zonën e Shkozetit, Durrës.
6. Transferimin e pronave të paluajhtësme shtetërore të sistemeve Ujësjetës –Kanalizimeve në pronësi të njëjsteve të qeverisjes vendore.
7. Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe fondit global për luftën kundër AIDS-it, turbekulozitet dhe malarjes, për programin "Përshkallëzimi i Përgjigjes kombëtare ndaj turbekulozitet".
8. Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe fondit global për luftën kundër AIDS-it, turbekulozitet dhe malarjes, për programin "Fuqizimi i përgjigjes kombëtare të Shqipërisë ndaj HIV/AIDS-it, për grupet e pambrojtura".
9. Për krijimin, përbërjen, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit ad hoc të lojrave të fatit, kazinovave dhe hipodromeve.

II. MBLEDHJE E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

datë 25.10.2006

VENDIME për propozime projektligjesh

1. Për propozimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ARTIGIANCASSA, S.P.A., për programin "Ristrukturimi dhe fuqizimi i sistemit elektrik Shqiptar, për integrimin në sistemin e Ballkanit: fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimi i kontrollit".
2. Për propozimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ARTIGIANCASSA, S.P.A., për financimin e programit "Fuqizimi i qendrës traumatologjike kombëtare të Tiranës".
3. Për propozimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ARTIGIANCASSA, S.P.A., për financimin e programit të rehabilitimit të rrugës Shkodër – Hani i Hotit".

4. Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ARTIGIANCASSA, S.P.A., për financimin e programit të rehabilitimit të rrugës Shkodër – Hani i Hotit.

5. Për propozimin e projektligjit "për disa shtesa e ndryshime dhe shtesa në ligjin 7796, datë 17.2.1994 "Ligji mineral i shqipërisë i ndryshuar. PROPOZIMIN.

6. Propozim projektligji "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 9267, datë 29.7.2004, për veprimtarinë e risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime e risigurime".

7. Propozim projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ARTIGIANCASSA, S.P.A., për financimin e programit të rehabilitimit të Portit të Vlorës".

VENDIME të Këshillit të Ministrave datë 07.09.2006

1. Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ARTIGIANCASSA, S.P.A., për programin "Ristrukturimi dhe fuqizimi i sistemit elektrik shqiptar, për integrimin në sistemin e Ballkanit: fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimi i kontrollit".

2. Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ARTIGIANCASSA, S.P.A., për financimin e programit "Fuqizimi i qendrës Traumatologjike kombëtare të Tiranës".

3. Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe ARTIGIANCASSA, S.P.A., për financimin e programit të rehabilitimit të Portit të Vlorës.

4. Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7796, datë 17.2.1994, "Ligji mineral i Shqipërisë", të ndryshuar.

5. Për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe INALCA, SPA, CASTELVETRO DI MODENA (Itali) dhe ALMED, SRL, Trieste, (Itali), për riskedulimin e borxheve të prapambetura.

6. Për dhënie ndihme financiare disa familjeve të dëmtuara, respektivisht, nga tërmetet e datave 6 e 8 gusht 2006 dhe 13 qershor 2006, në bashkitë e komunat e qarqeve Vlorë e Gjirokastër.

7. Për kriteret e masën e shpërblimit të punonjësit të shërnimit informativ të shtetit.

8. Kriteret dhe masën e përfitimit të pagës së papunësisë nga bashkëshorti-ja e punonjësit të shërbimit informativ të shtetit.

9. Për miratimin, në parim, të memorandumit të mirkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Arabe të Egjiptit, për bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë dhe të farmaceutikës.

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Organizimin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

(Vijon nga faqja 1)

4. Riformulimit të dispozitave, që lidhen me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve për veprimet e tyre në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës apo të veprimeve, të tjera që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit dhe autoritetin e drejtësisë.

5. Rivlerësimin të rolit të Ministrit të Drejtësisë në funksionin tradicional të nisjes së procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve, duke bërë një ndarje më të qartë të detyrave ndërmjet dy inspektorateve, të Ministrisë dhe të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

6. Marrjes së masave, për të shmangur fenomenet negative, që stimulojnë zvarritjet e pafund të proceseve gjyqësore, qëndrimet subjektive të pamotivuar ligjërisht të gjyqtarëve ndaj aksesit dhe kërkesave të ligjshme të qytetarëve në gjykime.

Në hartimin e këtij projektligji u morën parasysh mendimet dhe sugjerimet nga gjykatat e rretheve dhe të apelit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Avokati i Popullit, Prokuroria e Përgjithshme, Dhoma Kombëtare e Avokatëve etj., si dhe janë reflektuar disa vendime të marra nga Gjykata Kushtetuese, për vlerësimin dhe interpretimin e dispozitave kushtetuese, që lidhen me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, për akte dhe sjellje, që diskreditojnë figurën e tyre. Gjithashtu janë patur parasysh ligjet e vendeve fqinje, sidomos të atyre që njohin si autoritet të vetëm për emërimin, transferimin dhe vënien para përgjegjësisë së gjyqtarëve, Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Rregullimet e propozuara plotësojnë edhe një kusht tjetër të rëndësishëm, dhe janë në përputhje të plotë me aktet ndërkombëtare për pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si psh. rekomandimin Nr.R (94) 12, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, “Për pavarësinë, eficientën dhe rolin e gjyqtarëve”, Kartën e gjyqtarëve në Europë, etj.

Ndryshimet në këtë ligj, në përputhje dhe me dekretin e Presidentit, që mendohet të dalë së shpejti, për një riorganizim të gjykatave të shkallës së parë, do të shoqërohen, detyrimisht me ndërhyrje edhe në ligje të tjera, si për organizimin dhe funksionimin e KLD-së, për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë, Kodin e Procedurës Penale dhe të Procedurës Civile.

Më poshtë, në mënyrë më të hollësishme, paraqiten të rehat, që sjell ky projektligj, në raport me legjislacionin në fuqi:

- Për herë të parë krijohet gjykata administrative, e cila, fillimisht, është menduar të funksionojë në dy nivele në Tiranë, si gjykatë e shkallës së parë dhe si gjykatë apeli. Gjithsesi në këtë projektligj përcaktohet vetëm ngritja e gjykatës si institucion, sepse koha dhe veprimtaria e saj do të përcaktohen me ligj të veçantë.

- Në kuadër të riorganizimit gjyqësor, në bazë të një studimi të përgatitur më parë, është menduar shkrirja e gjykatave ushtarake, pasi nuk justifikonin ekzistencën e tyre, si nga pikëpamja funksionale, ashtu dhe ekonomike.

- Për herë të parë në ligj janë parashikuar detyrat, që duhet të kryejnë kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe afati kohor i qëndrimit të tyre në detyrë. Një parashikim i tillë pritet të rrisë përgjegjësinë

e tyre si titullarë të gjykatës, por edhe vendosjen e rregullit të disiplinës në gjykata, për përmbushjen sa më të mirë të funksioneve të tyre, në shërbim të dhënies së drejtësisë.

Për shkak të rëndësisë, që ka shorti në shpërndarjen e drejtë të punës në gjykata, por sidomos për shmangien sa më shumë të jetë e mendur të paragjykimëve, për fenomene korruptive, në përzgjedhjen e çështjeve për gjykim, propozohet të unifikohet mënyra e ndarjes së çështjeve, mënyrë e cila do të caktohet me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në funksion të përmirësimit të problemeve, të kamerës së gjyqtarëve, për të shmangur edhe vështirësitë e deritanishme, janë bërë formulime, që rregullojnë më mirë përcaktimin e kandidaturave sa më serioze për gjyqtarë të apelit dhe gjyqtarë të gjykatës së krimeve të rënda, duke futur nocionin e qëndrimit në listëpritjeje për të qenë të gatshëm sapo të paraqitet nevoja, pa u shkëputur nga funksioni i tyre. Një rregullim i ri i është bërë mënyrës së emërimit të kryetarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit. Deri tani këta janë emëruar në detyrë, nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Për të rritur garancitë në zgjedhjen e tyre, për analogji dhe me mënyrën e emërimit të gjyqtarëve, por edhe të kryetarit të Gjykatës së Lartë (shih nenin 136 të Kushtetutës) propozohet, që kryetarët e gjykatave të emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në të njëjtin nen të projektit janë vendosur, për herë të parë, kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për kryetarë të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit. Për herë të parë vendosen në ligj kriteret për mandatin e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit. Propozohet që kryetari të qëndrojë në këtë detyrë për 6 vjet, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme. Gjithashtu, janë propozuar edhe kriteret ligjore, për rastet e mbarimit të mandatit të kryetarit para kohe.

Përmirësime bëhen në këtë projektligj edhe për rastet e delegimit të gjyqtarëve nga një gjykatë në një tjetër, për rritjen e efektivitetit të gjykimit, mënjanimin e zvarritjeve dhe shmangien e ecejakjeve të panevojshme të qytetarëve nëpër gjykata, me synimin që gjykatat të jenë sa më pranë qytetarëve.

Ky projektligj plotëson një boshllëk për problemin e pagave, duke vendosur në ligj, krahas pagës së gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, edhe pagat e gjyqtarëve të gjykatave të krimeve të rënda. Për herë të parë, bazuar edhe në praktikën e disa vendeve të tjera, është parashikuar që gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, pas një përvoje 10-vjeçare si gjyqtar, të përfitojë shtesë page, në një masë të caktuar. Nisur nga aktet ndërkombëtare për pavarësinë e gjyqësorit, si dhe nga përvoja e vendeve të tjera, në këtë projektligj është parashikuar edhe një masë tjetër disiplinore ndaj gjyqtarëve: “Heqja e çështjeve nga shqyrtimi i mëtejshëm”.

Një masë e tillë do të ndikonte pozitivisht në shmangien e faktorëve, që bëhen shkak për korruption, do të shmangte zvarritjet pafund të proceseve, si dhe do t'i

(Vijon në faqen 7)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Organizimin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

(Vijon nga faqja 6)

shërbente rritjes së besimit të qytetarëve ndaj organeve të drejtësisë. Janë të shumta kërkesat që bëjnë qytetarët, të cilat për një arsye apo tjetër (ku nuk përjashtohet korrupsioni i gjyqtarëve) kërkojnë që çështja e tyre tu hiqet gjyqtarëve, që e kanë në shqyrtim, dhe t'u caktohet të tjerëve.

Ndryshime të rëndësishme janë parashikuar edhe për të drejtën e nisjes së procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve nga ana e Ministrit të Drejtësisë. Duke patur parasysh se, nga njëra anë, kjo është një kompetencë tradicionale e ministrit (jo vetëm në Shqipëri por edhe në vende të tjera të zhvilluara si Francë, Itali, etj.) dhe nga ana tjetër, ekzistencën e dy inspektorateve për kontrollin e gjykatave, është bërë një përpjekje për të ndarë sa më mirë fazat, kur futen në veprim inspektoratet përkatëse (i Ministrisë së Drejtësisë dhe i KLD-së). Kjo ndarje do t'i shërbejë vlerësimit objektiv të punës së gjyqtarëve, duke forcuar jo vetëm pavarësinë e inspektorateve, por edhe të gjykatave. Gjithashtu, një zgjidhje e tillë do të shmangte një lloj ortakllëku dhe ndarje përgjegjësie, që është manifestuar në punën e të dy inspektorateve. Risi të dukshme në këtë drejtim paraqet edhe njohja për herë të parë e kompetencës së kryetarëve të gjykatave për të ndërmarrë procedimin disiplinor të gjyqtarëve përpara Këshillit të Lartë të Drejtësisë në rastet e marrjes së masave, të parashikuara në shkronjat “a”, “b” e “c”, të nenit 35.

Ndryshim tjetër i rëndësishëm është edhe vendosja e një detyrimi (në paragrafin e dytë) që fillimi i procedimit disiplinor mund të bëhet me kusht që të mos kenë kaluar 6 muaj nga përfundimi i kontrollit. Mungesa e një parashikimi të tillë ka bërë që shumë shkelje të vëna re nga kontrollet e inspektorateve janë parashikuar. Për më tepër respektimi rigoroz i afateve ligjore u shërben më mirë goditjes në kohë të shkeljeve, rritjes së përgjegjësisë së Ministrisë së Drejtësisë, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe parandalimit të tyre.

Në nenin 43 është parashikuar vlerësimi profesional i gjyqtarëve dhe ngarkon Këshillin e Lartë të Drejtësisë për të rivlerësuar, brenda një viti, gjyqtarët të cilët gjatë vlerësimit të mëparshëm janë vlerësuar “pranueshëm”, masë kjo që i shërben kualifikimit të mëtejshëm të gjyqësorit. Projektligji në ndryshim nga i mëparshmi përcakton procedurën e dhënies së autorizimit për fillimin e ndjekjes penale të gjyqtarit dhe autorizimin në rastin e krimit të flagrancë.

Projektligji, gjithashtu, krijon edhe regjistrin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, si dhe përcakton dokumentacionin, që duhet të përmbajë ky regjistër.

Nëpërmjet përcaktimeve të sipërpërmendura synohet të krijohet një bazë e re ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, që do të thotë krijimin e një baze ligjore për rritjen dhe konsolidimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe, në të njëjtën kohë, transparencë dhe luftë ndaj efekteve negative të korrupsionit, në çdo formë shfaqjeje të tij.

Projektligji është fryt i një pune mëse 8-mujore të Ministrisë së Drejtësisë dhe i një bashkëpunimi të suksesshëm me organizata ndërkombëtare, që asistojnë sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Ai është konsultuar me këto organizata mëse një herë dhe për të janë dhënë mendimet nga misioni EURALIUS, Këshilli i Europës e OSBE-ja, si dhe nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Në të njëjtën kohë, hartimi i këtij projektligji vlerësohet si mishërim i një tradite 15-vjeçare të jurisprudencës dhe legjislacionit shqiptar. Përmbajtja e tij reflekton dhe është vazhdim i kësaj tradite dhe përpiket të pasqyrojë në legjislacion dinamikën e zhvillimit të shoqërisë shqiptare dhe përballjen e saj me sfidat e integritetit evropian.

Në datë 20 qershor 2006, me nismën e Ministrisë së Drejtësisë, u organizua një tryezë e përbashkët me këto institucione ndërkombëtare, Konferencën Gjyqësore Kombëtare, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe juristët më me zë të vendit, e cila u vlerësua si nga forma dhe nga përmbajtja e saj. Në këtë konferencë u paraqitën opsione dhe mendime, të cilat janë reflektuar në këtë projekt.

PROJEKTLIGJ PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 2, shkronja “a” dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton krijimin, organizimin dhe kompetencat e gjykatave, kushtet dhe procedurat për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarëve, masat disiplinore dhe shkarkimin e tyre, si dhe çështje të tjera për funksionimin e gjykatave.

Neni 2

Dita e drejtësisë

Dita përkujtimore e drejtësisë është data 10 maj.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GJYKATAVE

Neni 3

Pushteti gjyqësor

Pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë.

Neni 4

Gjykatat e shkallës së parë

1. Gjykata të shkallës së parë janë gjykatat e rretheve gjyqësore, gjykatat administrative dhe gjykatat e krimeve të rënda.

2. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata në fusha të veçanta por, në asnjë rast, gjykata të jashtëzakonshme.

Neni 5

Organizimi dhe kompetencat e gjykatave

1. Gjykatat e rretheve gjyqësore organizohen dhe funksionojnë në rrethe gjyqësore, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

(Vijon në faqen 8)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Organizimin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

(Vijon nga faqja 7)

2. Gjykatat administrative dhe gjykatat për krimet e rënda organizohen dhe funksionojnë në një a më shumë rrethe gjyqësore.

3. Kompetencat tokësore dhe qendra e ushtrimit të vep-
rimtarisë për secilën prej tyre përcaktohen me dekret të
Presidentit të Republikës, me propozimin e Ministrit të
Drejtësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Këshillit të
Lartë të Drejtësisë.

4. Gjykatat e apelit funksionojnë në zona, të caktuara
nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Ministrit të
Drejtësisë, pasi të jetë marrë edhe mendimi i Këshillit të
Lartë të Drejtësisë.

Neni 6

Numri i gjyqtarëve

Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të gjykatave të sh-
kallës së parë dhe të apelit caktohet me dekret të Presi-
dentit të Republikës, me propozimin e Ministrit të Drejtë-
sisë, pasi ky i fundit të ketë marrë mendimin e Këshillit
të Lartë të Drejtësisë.

Neni 7

Gjykata e Lartë

1. Gjykata e Lartë është autoriteti më i lartë gjyqësor, i
cili ka juridiksion, fillestar dhe rishikues.

2. Organizimi dhe funksionimi i Gjykatës së Lartë përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 8

Ndarja e çështjeve gjyqësore

Ndarja e çështjeve gjyqësore bëhet me short, sipas procedurave të caktuara me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

KREU III

KUSHTET PËR T’U PRANUAR GJYQTAR I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DHE TË APELIT

Neni 9

Kushtet për t’u emëruar gjyqtarë

Gjyqtarë mund të emërohen shtetasit shqiptarë, që përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jenë me arsim të lartë juridik;
- Të kenë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
- Të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;
- Të gëzojnë integritet të mirë.

Neni 10

Stazhi profesional i studentëve të Shkollës së Magjistraturës

1. Stazhi profesional i studentëve, që kanë mbaruar vitin e dytë të Shkollës së Magjistraturës, kryhet në gjykatat që kanë kushte më të mira, me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Qëllimi i stazhit profesional për studentët e Shkollës së Magjistraturës sipas pikës 1, të këtij neni, është sigurimi i përvojës dhe njohurive të nevojshme praktike për t’u emëruar si gjyqtarë dhe për të vlerësuar aftësitë e tyre profesionale për këtë emërim.

3. Studentit të Shkollës së Magjistraturës, në stazhin profesional i caktohet një gjyqtar mbikëqyrës, me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjatë stazhit studenti i magjistraturës, përfshihet në përgatitjen e materialeve

të çështjes gjyqësore, si dhe kryen detyrat, këshillimore dhe studiuuese, të çështjes në shqyrtim gjyqësor.

4. Në përfundim të periudhës së stazhit profesional, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në bazë të rezultateve të studimeve dhe të raportit nga gjyqtari mbikëqyrës, të paraqitur nga Shkolla e Magjistraturës, i propozon Presidentit të Republikës emërimin e tij si gjyqtar në një gjykatë të shkallës së parë, sipas nevojave, që ato kanë.

Neni 11

Emërimi i gjyqtarëve

1. Gjyqtarët në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Nëse Presidenti nuk emëron në detyrën e gjyqtarit kandidatët e propozuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes, propozimi vlerësohet i rrëzuar.

Neni 12

Emërimi i gjyqtarëve në gjykatat e apelit

1. Gjyqtarët e gjykatave për krimet e rënda dhe të gjykatave të apelit emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në bazë të konkurrimit me jetëshkrime, pasi:

- të kenë punuar jo më pak se pesë vjet në gjykatat e shkallës së parë;
- të jenë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;
- të jenë vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e tyre profesionale dy herët e fundit;
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi.

2. Gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë, që përmbushin kushtet e pikës 1, vazhdojnë të kryejnë funksionin e tyre, duke qëndruar në listën e pritjes.

3. Plotësimi i vendeve vakante në gjykatat e apelit dhe në gjykatat e krimeve të rënda bëhet vetëm nga kandidatët e listës së pritjes, sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Lista e pritjes mbahet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe përmban të dhënat për gjyqtarin për përvojën në punë dhe përgatitjen profesionale. Lista e pritjes dhe çdo ndryshim në të bëhen publike.

Neni 13

Betimi i gjyqtarëve

1. Para fillimit të detyrës, gjyqtarët bëjnë betimin, si më poshtë vijon:

“Betohe më solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale”.

2. Betimi i gjyqtarëve të sapoemëruar bëhet para gjyqtarëve të gjykatës, ku janë caktuar për të kryer detyrën, nën kujdesin e kryetarit të gjykatës.

Neni 14

Kushtet dhe emërimi i kryetarëve të gjykatave

1. Kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit emërohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

(Vijon në faqen 9)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Organizimin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

(Vijon nga faqja 8)

2. Kandidatët për kryetarë të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit duhet të plotësojnë këto kritere:

- Të kenë punuar jo më pak se katër vjet si gjyqtarë në gjykatat e të njëjtit nivel ose të niveleve më të larta;
- Të jenë vlerësuar “shumë mirë” nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dy herët e fundit;
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të kenë aftësi, organizuese dhe menaxhuese.

3. Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe i gjykatës së apelit nuk mund të jenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 15

Qëndrimi në detyrë dhe lirimi i kryetarëve të gjykatave

1. Kryetarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit qëndrojnë në detyrë për gjashtë vjet, me të drejtë riemërimi, jo të menjëhershëm.

2. Mandati i kryetarit mbaron para afatit kur:

- plotëson kushtet e nenit 18, të këtij ligji;
- shkarkohet nga detyra sipas pikës 2, të nenit 33, të këtij ligji;
- nuk përmbush detyrat e përcaktuara, në nenin 16, të këtij ligji.

3. Mbarimi i mandatit të kryetarit të gjykatës deklarohet me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me kërkesë të motivuar të çdo anëtari të këtij këshilli.

Neni 16

Kompetencat e kryetarit të gjykatës

1. Një herë në çdo dy vjet, kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit përcaktojnë, për vitin në vazhdim, shpërndarjen e gjyqtarëve në:

- seksionin penal, ku përfshihen edhe çështjet penale ushtarake;
- seksionin civil;
- seksionin administrativ;
- seksionin tregtar;
- seksionin për të miturit dhe të së drejtës familjare.

Kjo ndarje nuk e pengon kryetarin e gjykatës, që, gjatë vitit kalendarik, për nevoja pune, të komandojë gjyqtarë, për të gjykuar në një seksion tjetër.

2. Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit, përveç sa më sipër, kryejnë edhe këto detyra:

- Përfaqësojnë gjykatën në marrëdhëniet me të tretët;
- Bëjnë ndarjen e gjyqtarëve në trupa gjyqësore;
- Mbikëqyrin procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe nënshkruajnë përcjelljen e praktikës së çështjes gjyqësore te gjyqtari i caktuar;
- Në fillim të çdo muaji, bëjnë planifikimin e gjyqtarëve për gjykimet me objekt vlerësimin e arrestit në flagrancë apo ndalimit, caktimin e masave të sigurisë dhe çdo kërkesë tjetër gjatë fazës së hetimit, sipas rendit alfabetik, me bazë mbiemrin;
- Organizojnë diskutimet për çështje të natyrës juridike, bazuar në përgjithësimin e përvojës së gjykimet, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e gjykatave të tjera, vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

aktet e kontrollit dhe të inspektimit, të ushtruara nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe i Ministrisë së Drejtësisë;

dh) Në bashkëpunim me kancelarin, ndjekin ecurinë e dorëzimit të dosjeve gjyqësore, të përfunduara në sekretarinë gjyqësore, në përputhje me afatet procedurale, të parashikuara nga ligji;

e) Kontrollon ecurinë e dosjeve gjyqësore për zvarritje në gjykim apo mosrespektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit, si dhe kërkojnë respektimin e afateve procedurale, të parashikuara nga ligji;

ë) Marrin kontakt me ekipet e kontrollit të Ministrisë së Drejtësisë apo të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, njihen me qëllimin dhe objektin e kontrollit dhe u krijojnë atyre mundësi në ushtrimin e detyrës;

f) Sigurojnë mjedis të veçantë brenda gjykatës për studimin e dosjeve gjyqësore nga avokatët, prokurorët, ekspertët, përfaqësuesit e palëve ose personat, që e kanë këtë të drejtë;

g) Shpallin listën e ekspertëve të licencuar, sipas fushave përkatëse;

gj) Përcaktojnë orarin e pritjes së popullit dhe miratojnë orarin e shërbimeve, që përmbushen nga strukturat e administratës gjyqësore;

h) Ndjekin disiplinën në punë të gjyqtarëve dhe të punonjësve të tjerë të gjykatës dhe, për shkeljet e vëna re nga gjyqtarët, njoftojnë Ministrin e Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë;

i) Bashkërendojnë punën me Shkollën e Magjistraturës, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë për çështje të ngritjes profesionale të gjyqtarëve;

j) Kujdesen për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në gjykatë;

k) Kryejnë detyra të tjera, në funksion të drejtimit administrativ të gjykatës, të parashikuara në akte ligjore ose nënligjore, në fuqi.

3. Në mungesë të kryetarit, detyrat e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, kryhen nga një gjyqtar i autorizuar prej tij, brenda 7 ditësh nga emërimi në detyrë. Për gjykatën e rrethit gjyqësor, Tiranë, autorizohen, sipas fjalisë së parë, të kësaj pike, dy gjyqtarë.

Neni 17

Regjistri i gjyqtarëve

Pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë krijohet regjistri i gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, i cili përmban të paktën:

- gjeneralitetet e çdo gjyqtari;
- të dhënat e edukimit të tij akademik;
- datën e emërimit;
- pjesëmarrjen në kualifikime dhe trajnime;
- vendime disiplinore nëse ka;
- vlerësimin e tij si gjyqtar, sipas nenit 35;
- të dhëna për karrierën gjyqësore.

KREU IV

STATUSI I GJYQTARËVE

Neni 18

Lëvizja e gjyqtarit nga detyra

(Vijon në faqen 10)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji "Për Organizimin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"

(Vijon nga faqja 9)

Gjyqtarët nuk mund të lëvizin nga detyra, përveç kur:

- a) japin dorëheqjen;
- b) mbushin moshën 65 vjeç, të daljes në pension;
- c) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- ç) merret masa e shkarkimit nga detyra.

Neni 19

Transferimi dhe ngritja në detyrë

1. Ngritja në detyrë dhe transferimi i gjyqtarit mund të bëhen vetëm me pëlqimin e tij.

2. Në rastet kur një gjykatë nuk funksionon normalisht, për shkak të mungesës së përkohshme të gjyqtarëve, për shkak të mosplotësisë së vendeve vakante ose për shkak të mbingarkesës së punës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e kryetarit të gjykatës përkatëse mund të delegojë, për çështje të caktuara, gjyqtarë nga gjykata të tjera, për një periudhë jo më shumë se tre muaj në vit, edhe pa pëlqimin e gjyqtarit.

Në këtë rast, gjyqtari përfiton një shtesë 5 për qind mbi pagën, e cila përballohet nga gjykata, ku është emëruar. Me mbarimin e këtij afati gjyqtari kthehet përsëri në vendin e mëparshëm.

Neni 20

Në rastet kur, në përputhje me dekretin e Presidentit të Republikës, një rreth gjyqësor ka në juridiksionin e tij dy ose më shumë gjykata, kryetari i gjykatës, ku ka qendrën e veprimtarisë rrethi gjyqësor, në varësi të numrit dhe të karakterit të çështjeve, cakton me short, sipas një grafiku të veçantë, gjyqtarët, që do të gjykojnë këto çështje.

Neni 21

Papajtueshmëritë me detyrën e gjyqtarit

Gjyqtari nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore, private ose politike, me përjashtim të mësimdhënies në shkollat e larta ose në Shkollën e Magjistraturës.

Neni 22

Detyrimet e gjyqtarëve

Gjyqtarëve u ndalohet:

- a) të bëjnë pjesë në parti politike ose të marrin pjesë aktive në veprimtari me karakter politik;
- b) të marrin pjesë në administrimin apo drejtimin e shoqërive tregtare, personalisht ose me anë përfaqësimi;
- c) të jenë ekspertë ose arbitër të palëve në arbitrazh;
- ç) të bëjnë deklarata në publik për proceset;
- d) të bëjnë të ditur mendimet e dhëna gjatë seancave të gjykimit, që ende nuk kanë marrë formën e një vendimi;
- dh) të bëjnë publike, akte ose dokumente zyrtare, me karakter sekret ose konfidencial;
- e) të bëjnë deklarata në publik për çdo gjë tjetër, që cenon paanshmërinë në proces.

Neni 23

Solemniteti i gjykimit

1. Gjyqtarët, gjatë gjykimit të çështjes, duhet të respektojnë solemnitetin e gjykimit dhe të mbajnë veshje të posaçme.

2. Rregullat për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen përcaktohen me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 24

Të drejtat dhe detyrimet e tjera të gjyqtarëve

1. Gjyqtarët duhet të ruajnë dinjitetin e tyre, duke mos lejuar veprime që kompromentojnë profesionin, organet e drejtësisë dhe figurën e tyre në shoqëri.

2. Gjyqtarët mund të krijojnë shoqata ose organizata, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre, si dhe për ngritjen profesionale.

3. Gjyqtarëve u ndalohet të bëjnë greva.

Neni 25

Gjyqtari nuk përgjigjet në një padi civile, e cila lidhet me kryerjen e detyrave të tij profesionale, me përjashtim të rasteve, kur parashikohet shprehimisht me ligj.

Neni 26

Të drejtat e gjyqtarëve

1. Gjyqtarët kanë të drejtë:

a) të kenë një mbrojtje të veçantë nga ministria, që mbulon rendin publik, për vete, familjen dhe pronën, kur një gjë të tillë e kërkojnë ata vetë, për rrethana serioze, që u kërcënojnë jetën, familjen dhe pronën.

b) të përfitojnë falas "Fletoren zyrtare" dhe revistat juridike.

Gjyqtarët përfitojnë leje të pagueshme vjetore, prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajin gusht. Gjyqtarët e ngarkuar për kryerjen e detyrave të ngutshme në muajin gusht, lejen vjetore e bëjnë në një periudhë tjetër, duke përfituar pesë ditë shtesë.

3. Gjyqtarët, që kryejnë detyra të ngutshme në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare, përfitojnë shtesë page, në masën 50 për qind të pagës së tyre ditore.

Neni 27

Paga e gjyqtarit dhe e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë

1. Paga fillestare e gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Paga e kryetarit të gjykatës së shkallës së parë është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Paga e kryetarit të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë, është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

4. Paga e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Paga e kryetarit të Gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 70 për qind të pagës të anëtarit të Gjykatës së Lartë.

6. Gjyqtarët e shkallës së parë, që kanë vjetërsi pune në këtë detyrë jo më pak se 10 vjet, përfitojnë, çdo muaj, shtesë page 5 për qind të pagës së tyre mujore.

Neni 28

Paga e gjyqtarit dhe e kryetarit të gjykatës së apelit

1. Paga fillestare e gjyqtarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

(Vijon në faqen 11)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Organizimin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

(Vijon nga faqja 10)

2. Paga e kryetarit të Gjatës së apelit është e barabartë me 80 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjatës së Lartë.

3. Paga e kryetarit të Gjatës së apelit, Tiranë, është e barabartë me 90 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjatës së Lartë.

4. Paga e gjyqtarit të gjatës së apelit të krimeve të rënda është e barabartë me 75 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjatës së Lartë.

5. Paga e kryetarit të gjatës së apelit të krimeve të rënda është e barabartë me 90 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjatës së Lartë.

Neni 29

Gjyqtarët, që shërbejnë në Ministrinë e Drejtësisë

1. Gjyqtarët mund të shërbejnë si nëpunës civilë në Ministrinë e Drejtësisë. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar, për efekt të karrierës personale, parashikuar në dispozitat ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjatës së Lartë dhe Gjatës Kushtetuese.

2. Gjyqtarëve, që shërbejnë si nëpunës civilë në Ministrinë e Drejtësisë, me kërkesën e tyre, u garantohej të paktën, kthimi në funksionin e gjyqtarit në gjatën, ku kanë punuar para emërimit, sipas pikës 1, të këtij neni.

Neni 30

Imuniteti i gjyqtarëve

1. Gjyqtari i Gjatës së shkallës së parë ose i gjatës së apelit mund të ndiqet penalisht vetëm me miratimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese për miratimin për fillimin e ndjekjes penale ndaj gjyqtarit i paraqiten kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet prokurorit të Përgjithshëm.

2. Gjyqtari, për të cilin kërkohet miratimi, lajmërohet për kërkesën e bërë dhe dokumentet, që e shoqërojnë atë, si dhe i bëhet e ditur koha kur Këshilli i Lartë i Drejtësisë do të fillojë shqyrtimin e kërkesës. Gjyqtari ka të drejtë të paraqesë, me shkrim ose me gojë, shpjegime dhe vërejtje rreth çështjes.

3. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, brenda 3 ditëve, duhet të vendosë për miratimin ose jo të ndjekjes penale të gjyqtarit. Në rastin kur këshilli nuk merr vendim për dhënien ose mosdhënien e miratimit për fillimin e ndjekjes penale të gjyqtarit, brenda 2 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës përkatëse, atëherë kërkesa vlerësohet e rrëzuar. Në rastet kur vendoset fillimi i ndjekjes penale, gjyqtari pezullohet nga detyra deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë. Në rastet kur shpallet i pafajshëm, me vendim gjyqësor të formës së prerë, gjyqtari ka të drejtë të rikthehet në detyrën e mëparshme dhe të përfitojë pagën e plotë, që nga data e pezullimit.

4. Në rastin kur një gjyqtar është ndaluar ose arrestuar në kryerje e sipër të një krimi, ose menjëherë pas kryerjes së tij, organi kompetent vë në dijeni menjëherë, kryetarin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili thërret menjëherë mbledhjen e këshillit, për të dhënë pëlqimin ose jo për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, duke dëgjuar, nëse është e nevojshme, përfaqësuesin e

organi kompetent ose gjyqtarin e ndaluar apo të arrestuar. Në qoftë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të ndaluar ose të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

KREUV

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE E GJYQTARËVE

Neni 31

Përgjegjësia gjyqtarëve

Gjyqtarët kanë përgjegjësi për shkelje të disiplinës dhe për kryerjen e akteve e të sjelljeve, që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tyre.

Neni 32

Përgjegjësia disiplinore dhe shkarkimi

1. Vlerësohen shkelje të disiplinës:

a) Mungesat pa arsye në punë për 3 ditë rresht.

b) Zvarritjet e pajustificuara apo shkeljet e përsëritura të ligjit procedural gjatë gjykimit..

c) Nxjerrja e akteve sekrete, që lidhen me çështjen, të dhomës së këshillimit ose të të dhënave të tjera, me karakter intim.

ç) Mosrespektimi i rregullave të solemnitetit, sipas nenit 23, të këtij ligji.

d) Moskryerja e veprimeve të detyrueshme procedurale ose kryerja e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, kur nuk përbëjnë vepër penale. dh) Kryerja e veprimeve që, sipas këtij ligji ose ligjeve të tjera në fuqi, janë të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit.

Neni 33

Masat disiplinore

1. Për shkelje të disiplinës merren këto masa:

a) Vërejtje.

b) Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra.

c) Heqja e çështjes nga shqyrtimi i mëtejshëm.

ç) Gjobë deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë.

d) Ulje në detyrë në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të ulët.

2. Gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit shkarkohen nga detyra, kur vërtetohen kushtet e parashikuara në pikën 6, të nenit 147 të Kushtetutës.

3. Masat disiplinore, sipas pikës 1, të këtij neni, shlyhen në qoftë se brenda 2 vjetësh nga data e dhënies së tyre, për shkronjën “a”, të pikës 1, dhe brenda 3 vjetësh, për shkronjat “b”, “c”, “ç” e “d”, të pikës 1, nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake e gjyqtarit.

Neni 34

Procedimi disiplinor i gjyqtarëve

1. Të drejtën e nisjes së procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve e ka Ministri i Drejtësisë, në bazë të propozimeve të bëra nga inspektorët e kësaj ministrie ose të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

2. Përveç Ministrisë të Drejtësisë, kryetari i gjykatës ka të drejtë t'i propozojë Këshillit të Lartë të Drejtësisë marrjen ndaj gjyqtarëve të masave disiplinore; parashikuar

(Vijon në faqen 12)

PROJEKTLIGJE NË PROCES

Projektligji “Për Organizimin Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

(Vijon nga faqja 11)

në shkronjat “a”, “b” e “c”, të pikës 1, të nenit 33, të këtij ligji.

3. Fillimi i procedimit disiplinor bëhet brenda 6 muajve nga data e mbarimit të kontroilit. Procedimi disiplinor realizohet brenda tre vjetësh nga kryerja e shkeljes përkatëse.

4. Gjatë verifikimit, që bëhet nga inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë ose të Ministrisë së Drejtësisë, përcaktohet nëse është kryer ndonjë shkelje e parashikuar në ligj, lloji dhe rëndësia e saj, si dhe të dhëna, mbi të cilat mbështeten përfundimet e nxjerra.

Në çdo rast, inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë ose të Ministrisë së Drejtësisë detyrohen të dëgjojnë dhe të verifikojnë pretendimet e gjyqtarit.

6. Rezultatet e verifikimeve, si dhe të dhënat shkresore rreth tyre, i paraqiten gjyqtarit përkatës dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të paktën 10 ditë para mbledhjes.

Neni 35

Vlerësimi profesional i gjyqtarëve

I. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, të paktën një herë në tre vjet, bën vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarëve, në përputhje me vendimin e miratuar prej tij, për kriteret e vlerësimit. Vlerësimi profesional është:

- a) Shumë i mirë.
- b) Mirë.
- c) Pranueshëm
- ç) I paaftë.

2. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë i komunikon gjyqtarit projektaktin e vlerësimit të aftësive të tij profesionale dhe gjyqtari ka të drejtë të paraqesë kundërshtimet e veta, brenda 15 ditësh nga data e njoftimit.

3. Vlerësimi “I paaftë” përbën shkak për fillimin e procedurës për shkarkimin nga detyra.

4. Në rastin kar gjyqtari është vlerësuar “Pranueshëm”, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, brenda një viti, bën rivlerësimin e tij.

Neni 36

Ankimi ndaj vendimit të shkarkimit të gjyqtarit
Ndaj vendimit të shkarkimit nga detyra, gjyqtari ka të drejtë të ankohet, brenda 15 ditësh nga njoftimi i vendimit, në Gjykatën e Lartë, e cila vendos me kolegje të bashkuara.

KREU VI

ADMINISTRIMI I SHËRBIMEVE NË GJYKATË

Neni 37

Kancelari i gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit

1. Kancelari i gjykatës drejton dhe përgjigjet për shërbimet ndihmëse në gjykatë.

2. Kancelar emërohet një jurist, i cili ka përvojë pune prej jo më pak se pesë vjetësh në këtë profesion.

3. Kancelari përfiton pagë dhe leje të pagueshme vjetore, të njëjta me ato të gjyqtarit të gjykatës përkatëse, ku ushtron funksionet.

4. Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga ministri i Drejtësisë.

Neni 38

Administrata gjyqësore

1. Shërbimet ndihmëse në gjykatë kryhen nga sekretaria gjyqësore, degët dhe sektorët e administratës, të ekonomisë, financës, informatizimit, regjistrimit dhe ruajtjes së dokumenteve.

2. Procedura e emërimit, shkarkimit, të drejtat dhe detyrimet e administratës gjyqësore, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 39

Buxheti i pushtetit gjyqësor

1. Pushteti gjyqësor ka buxhet të veçantë, i cili administrohet prej tij, sipas kriterëve të përcaktuara në ligj të veçantë.

2. Në asnjë rast gjykatat nuk mund të pranojnë fonde ose donacione private.

Neni 40

Rendi dhe siguria në gjykatë

Për të garantuar rendin dhe sigurinë, pranë gjykatave organizohet shërbim i vazhdueshëm i Policisë së Shtetit, i cili vepron sipas urdhërave të kryetarit të gjykatës.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 41

Riorganizimi gjyqësor

1. Pavarësisht nga pika 1, e nenit 19, të këtij ligji, kur një gjykatë mbyllet ose numri i gjyqtarëve zvogëlohet, për shkak të riorganizimit gjyqësor, gjyqtari mund të transferohet në një gjykatë tjetër, të të njëjtit nivel ose më të ulët apo në vende të tjera, brenda sistemit të drejtësisë.

2. Në rast se transferimi, sipas pikës 1, refuzohet, atëherë refuzimi përbën shkak për lirimin nga detyra të gjyqtarit.

3. Në rast se transferimi, sipas pikës 1, është i pamundur, gjyqtari futet në një listë të veçantë dhe ka përparësi emërimi në vendin më të parë vakant, që krijohet. Deri në periudhën e emërimit të ri ai merr 80 përqind të pagës.

Neni 42

Koha e fillimit të gjykatave administrative

Koha e fillimit dhe veprimtaria e gjykatave administrative përcaktohen me ligj.

Neni 43

Dispozitë kalimtare

Çështjet, të cilat, në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shqyrtohen nga seksionet penale ushtarake apo gjykata e apelit ushtarak, do të përfundojnë po nga këto seksione apo gjykata.

Neni 44

Shfuqizime

Ligji nr.8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19, i ligjit nr.8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shkronja “e”, e nenit 2, e ligjit nr.8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 45

Hyrja në fuqi

12 Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Projektligje të miratuara në Kuvend gjatë muajit shtator 2006.

Gjatë muajit shtator Kuvendi i Shqipërisë ka zhvilluar gjithsej 7 seanca plenare dhe janë miratuar gjithsej 13 ligje. 9 prej tyre kanë qenë ratifikime dhe aderime marrëveshjesh, konventash dhe dokumentash të ndryshëm, 3 kanë qenë projektligje organike dhe 1 shtesë ligjore në ligjet ekzistuese. Ligjet e miratuara janë të radhitura si më poshtë:

1. Ligj nr. 9604, datë 11.09.2006 "Për ratifikimin e konventës së bashkëpunimit policor për Europën Juglindore".
2. Ligj nr. 9605, datë 11.09.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD) për financimin e programit për zhvillimin e qendrueshëm të zonave rurale, malore".
3. Ligj nr. 9606, datë 11.09.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2004, "Programi i sektorit të energjisë" me një grant prej 9.000.000 eurosh".
4. Ligj nr. 9607, datë 11.09.2006 "Për Këshillin Konsultativ të Biznesit".
5. Ligj nr. 9608, datë 18.09.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Suedisë, për afatet dhe kushtet e përgjithshme të bashkëpunimit për zhvillim".
6. Ligj nr. 9609, datë 18.09.2006 "Për një shtesë në ligjin nr. 7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik" të ndryshuar".
7. Ligj nr. 9610, datë 18.09.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Izraelit, për shërbimin ajror".
8. Ligj nr. 9611, datë 18.09.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e kontrollit të gripit të shpendëve dhe përgatitjes për parandalimin e pandemisë humane".
9. Ligj nr. 9612, datë 21.09.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit "Për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit: fuqizimi i aftësive të transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit".
10. Ligj nr. 9613, datë 21.09.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e UNESCO-S, "Për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve të kulturave".
11. Ligj nr. 9614, datë 21.09.2006 "Për çertifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore".
12. Ligj nr. 9615, datë 27.09.2006 "Për ratifikimin e konventës, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Koresë, për shmangien e tatimeve të dyfishta, për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, dhe për parandalimin e evazionit fiskal".
13. Ligj nr. 9616, datë 27.09.2006 "Për librin në Republikën e Shqipërisë".

Projektligje të depozituara në Kuvend gjatë periudhës shtator-tetor 2006.

Gjatë periudhës shtator -tetor në Kuvend janë depozituar 14 projektligje. Nga projektligjet e depozituara vetëm 2 prej tyre janë me iniciativë të deputetëve ndërsa të tjerët janë paraqitur në Kuvend me iniciativë të qeverisë. Projektligjet janë të radhitura si më poshtë:

1. Projektligji "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë".
Paraqitur, më 06.09.2006
2. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për financimin e programit "Rehabilitimi i rrugës Shkodër - Hani i Hotit".
Paraqitur, më 13.09.2006
3. Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shumëpalësh të Konventës "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave (CMR)".
Paraqitur, më 13.09.2006
4. Projektligji "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë".
Paraqitur, më 21.09.2006
5. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik" të ndryshuar".
Paraqitur, më 25.09.2006
6. Projektligji "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".
Paraqitur, më 29.09.2006
7. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar i Bisedimit të Borxhit të Jashtëm, dhe shoqërisë "Mali" Gjakovë, për riskedulimin e borxhit të prapambetur".
Paraqitur, më 29.09.2006
8. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant'Egidio-s për selinë dhe veprimtarinë e këtij Komuniteti në Shqipëri".
Paraqitur, më 29.09.2006
9. Projektligji "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake".
Paraqitur, më 29.09.2006
10. Projektligji "Për prokurimin publik".
Paraqitur, më 13.10.2006
11. Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë".
Paraqitur nga një grup deputetësh më 13.10.2006
12. Projektligji "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit".
Paraqitur, më 17.10.2006
13. Projektligji "Për ratifikimin e Protokollit nr. 13 të Konventës Europiane, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, për heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat".
Paraqitur, më 17.10.2006
14. Projektligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Aktin e Gjenevës, të marrëveshjes së Hagës,

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 1)

6. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ushtarake grant, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë".

7. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër dopingut në sport, 2005".

8. P/Ligji "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin shumëpalësh të Konventës "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave (CMR)".

9. P/Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8618, datë 14.6.2000 "Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë".

10. P/Ligji "Për disa shtesa në ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar".

11. Shqyrtimi i propozimeve "Për zgjedhjen e një anëtarit të Këshillit Drejtues të Radio – Televizionit Publik Shqiptar".

PËR VOTIM:

1. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Jashtme, për realizimin e Programit "Fuqizimi i Qendrës Traumatojike Kombëtare të Tiranës".

2. P/Ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë "HACI SAKIR SABUN VE GLISERINE FABRIKALARI TURK ANONIM SIRKETI "STAMBOLL, TURQI", për riskedulimin e borxhit".

3. P/Ligji "Për ratifikimin e Protokollit për pranimin e Komunitetit Europian në Konventën Ndërkombëtare të Eurokontrollit, për bashkëpunimin për sigurinë e navigimit ajror, të 13 Dhjetorit 1960, të ndryshuar me anë të amendimit dhe të konsoliduar nga Protokollit i 27 Qershorit 1997".

4. P/Ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes shumëpalëshe "Për ngritjen e një rrjeti hekurudhor, të performacës së lartë, në Europën Juglindore".

5. P/Ligji "Për miratimin e Buxhetit Faktik të Shtetit të vitit 2005".

Veprimtari në Komisione - nga data 17 tetor - 1 nëntor 2006

1. P. ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant Egidio-s, për Selinë dhe Veprimtarinë e këtij komuniteti në Shqipëri".

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

. Komisioni i Jashtëm

. Komisioni i Integritit

. Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik

2. P/ ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar i bisedimit të borxhit të jashtëm dhe shoqërisë "MALI" Gjakovë për riskedulimin e borxhit të prapambetur".

. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

. Komisioni i Jashtëm

. Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

3. P/ ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes "Plani i Veprimeve të Programit për Shqipërinë 2006 – 2010" ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (PNUD)".

. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

. Komisioni i Jashtëm

. Komisioni i Integritit

. Komisioni i Ekonomisë dhe Financave

4. P / ligji "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

. Komisioni përgjegjës: Komisioni i Ekonomisë dhe Financave.

.Jep mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

5. P/ ligji "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit".

.Komisioni përgjegjës: Komisioni i Punës, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë

6.P/ ligji "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

. Komisioni përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

7. P/ ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8607, datë 27.04.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", të ndryshuar.

. Komisioni i Sigurisë Kombëtare

8. P/ ligji "Për disa ndryshime në Ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë".

. Komisioni përgjegjës: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

9. P/ ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8618, datë 14.06.2000 "Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë".

. Komisioni përgjegjës: Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

10. P/ ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9323, datë 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar.

(Vijon në faqen 15)

KALENDARI 3 JAVOR I PUNIMEVE TË KUVENDIT

(Vijon nga faqja 14)

· Komisioni përgjegjës: Komisioni i Punës, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë

11. P/ ligji "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë".

· Komisioni përgjegjës: Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

12. P/ ligji "Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë".

· Komisioni përgjegjës: Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit.

· Jep mendim: Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

13. P/ ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

· Komisioni i Punës, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë

· Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

14. P/ ligji "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira" (grup deputetësh).

(Është shtyrë në seancën e datës 1.06.2006 për ta shqyrtuar edhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financave).

15. P/ Ligji "Për Prokurorimet Publike".

· Komisioni përgjegjës: Komisioni për Ekonominë dhe Financat

· Jep mendim: Komisioni i Ligjeve, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

E martë, datë 24.10.2006, ora 17.00

Sencë Plenare-

1. Dikutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60')
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, datë 16.10.2006.

3. P/ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit të Sant Egidio-s, për Selinë dhe Veprimtarinë e këtij komuniteti në Shqipëri".

4. P/ligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për financimin e Programit "Rehabilitimi i rrugës Shkodër – Hani i Hotit".

5. P/ligji "Për Factoringun".

6. P/ligji "Për Artin Skenik".

7. P/ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë".

8. P/ligji "Për sistemin e taksave vendore" (nen për nen).

E enjte, datë 26.10.2006, ora 10.00

Sencë Plenare-

1. Dikutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60')
2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare, datë 23.10.2006.

3. P/ ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për-

faqësuar nga Komiteti Qeveritar i bisedimit të borxhit të jashtëm dhe shoqërisë "MALI" Gjakovë për riskedulimin e borxhit të prapambetur".

4. P / ligji "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

5. Miratimi i Draft Rezolutës "Domosdoshmëria për dënimin e krimeve të kryera nga rregjimi komunist i Enver Hoxhës në Shqipëri".

E hënë, datë 30.10.2006, ora 17.00

Sencë Plenare-

1. Dikutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60')

2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare, datë 26.10.2006.

3. Pyetje dhe Interpelanca.

4. P/ ligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes "Plani i Veprimeve të Programit për Shqipërinë 2006 – 2010" ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (PNUD)".

5. P/ ligji "Për Inspektoriatin e Punës dhe Inspektoriatin Shtetëror të Punës".

E enjte, datë 2.11.2006, ora 10.00

-Sencë Plenare-

1. Dikutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60')
2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare, datë 30.10.2006.

3. P/ ligji "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit".

4. P/ ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8618, datë 14.06.2000 "Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë".

5. P/ ligji "Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

6. P/ Ligji "Për Prokurorimet Publike".

7. P/ Ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në disa ligje organike" (për votim).

E hënë, datë 6.11.2006, ora 17.00

- Sencë Plenare -

1. Dikutime për çështje jashtë rendit të ditës (deri 60')
2. Miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare, datë 2.11.2006.

3. Miratimi i Kalendarit 3 javor të punimeve të Kuvendit.

4. Pyetje dhe Interpelanca.

5. P/ ligji "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë".

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/
Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdpd.org